

## GYJKATA E QARKUT NË PRISHTINË

P. Nr. 281/07

Data: 14 Qershor 2010

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në trupin gjykses të përbërë nga:

- 1) Gjykatësi i EULEX-it , Z. Ferdinando BUATTER DE MONGEOT, si kryetar i trupit gjykses,
- 2) Gjykatësi i EULEX-it, Z. Vladimir KANEV, anëtar i trupit gjykses
- 3) Gjykatëse Kosovare, Znj. Fëllanzë KADIU, anëtare e trupit gjykses,

Të asistuar nga sekretari i gjykatës të poshtë nënshkruar, në rastin penal kundër,

**Albin Kurtit**, i lindur në Prishtinë me 24 Mars 1975, i biri i Zaim Kurtit dhe Arife Kurtit, Shqiptar i Kosovës, banues në nr. 76 Rr. Kroni i Bardhë në Prishtinë, i pamartuar, i diplomuar në universitet, me status të mesëm ekonomik, i Akuzuar sipas aktakuzës PP-KT Nr. 5714/07 të ushtruar me 04 Qershor 2007 nga Prokurori Publik Ndërkombëtar Andrew Maves për veprë penale të

**Akuza 1:** Pjesëmarrja në Grup që kryen veprë penale siç është përcaktuar dhe për të cilën dënohet nën nenin 320, para. 2 të KPPK

**Akuza 2:** Pjesëmarrja në grupin që pengon personat zyrtar në kryejën e detyrave zyrtare siç është përcaktuar dhe për të cilën dënohet nën nenin 318, par. 1 dhe 2 të KPPK

**Akuza 3:** Thirrja për rezistencë siç është përcaktuar dhe për të cilën dënohet nën nenin 319, par. 1 të KPPK:

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publikisht me 14 Qershor 2010, në prani të Prokurorit Special Ali Rexha, dhe të akuzuarit;

Pas konstatimit të tërheqjes së akuzave 1 dhe 3 të aktakuzës të bëra nga Prokurori Publik gjatë seancës së 14 Qershor 2010;

Pas plegërimit nga trupi gjykses me 14 Qershor 2010, duke u bazuar në nenin 391 (1) dhe nenin 389 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon siç vijon

## **AKT GJYKIM**

### **Akuzat 1 dhe 3:**

Akuzat e ngritura kundër të pandehurit **Albin Kurti** për pikën 1 (“Pjesëmarrja në Grup që kryen vepër penale” sipas nenit 320, par. 2 të KPPK) dhe 3 (“Thirrje për Rezistencë” siç është përcaktuar dhe që dënohet nën nenin 319, paragrafi 1 të KPPK) të aktakuzës

### **REFUZOHEN**

sipas nenit 389 paragrafi 1 n. 1) KPPK

### **Akuza 2:**

I akuzuari **Albin Kurti** është

### **GJETTUR FAJTOR**

Për veprën penale të “Pjesëmarrja në grupin që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”, siç është përcaktuar dhe që dënohet nën nenin 318 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 sepse: me 10 Shkurt 2007 në mes 14.00 dhe 17.00 në Prishtinë, si drejtues i një grupi të madh të mbledhur afër Teatrit Kombëtar si pjesë e marshimit të protestës, me veprim të përbashkët ka penguar personat zyrtar (Policinë e SHPK dhe policinë e UNMIK-ut) në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare në parandalimin e grupit nga hyrja pa leje në kordonin e policisë, duke e bërë këtë personalisht dhe duke pasur pjesëmarrës tjerë në grup për të shtyrë përmes kordonit policor të njëjtit në kundërshtim me urdhrat e kundërt nga zyrtarët publik.

Prandaj, sipas nenit 318 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 dhe nenit 66 paragrafi 1 n. 2) të KPPK, **Albin Kurti**

### **DËNOHET**

me 9 muaj burgim

Sipas nenit 391 të KPPK dhe 73 të KPK koha e kaluar nga i akuzuari në paraburgim dhe në arrest shtëpiak do të përfshihet si pjesë e dënimit me burgim,

Sipas nenit 112 të KPPK palët e dëmtuara këshillohen që mund të ushtrojnë kërkesë për kompensim me çështje gjyqësore civile.

I akuzuari do të kompensoj shpenzimet e procesit penal sipas nenit 102 paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit dhe interpretimit. Një vendim i veçantë mbi shumën do të bëhet nga gjykata kur këto të dhëna të merren sipas nenit 100 paragrafi (2) të KPPK.

## ARSYETIMI

### 1. Historia Procedurale

Me 13 Shkurt 2007, është iniciuar hetimi kundër të pandehurit.

Me 4 Qershor 2007, Prokurori Ndërkombëtar, Andrew Mayes, ka ushtruar një aktakuzë kundër të akuzuarit për veprat penale të raportuara më lartë.

Me 6 Korrik 2007, gjykatësi i procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ka konfirmuar aktakuzën siç është ndryshuar gjatë seancën për konfirmim të mbajtur me 6 Qershor 2007.

Me 6 Shtator 2007, Kryetari i autorizuar i Tropic Gjykues ka lëshuar një urdhër për caktimin e shqyrtimit kryesor, të planifikuar të filloj me 19 Shtator 2007.

Me 7 Shkurt 2008, pas disa shtyrjeve, shqyrtimi kryesor ishte pezulluar me një aktvendim nga trupi gjykues, i cili pezulloi procesin për shkak të de facto pamundësisë të ketë një avokat mbrojtës për të përfaqësuar të pandehurin në proces që sipas nenit 73 të KPPPK, është paraparë si i detyrueshëm nga KPPPK.

Me 25 Dhjetor 2008, sipas vendimit n. JC/EIU/OPFJ/0038.gvc/09, të lëshuar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të Asamblesë së gjykatësve të EULEX-it, rasti është marrë në dorëzim nga EULEX.

Me 19 Janar 2010 sipas rregullave të brendshme mbi shpërndarjen e rasteve gjykatësve të EULEX-it komponentë e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Gjykatësi Ferdinando Buatier de Mongeot ishte caktuar si kryetar i trupit gjykues për shqyrtim kryesor. Anëtarë tjerë të trupit gjykues ishin Gjykatësi i EULEX-it Vladimir Kanev dhe Gjykatësjja e Kosovës Flilanza Kadriu.

Me 21 Janar 2010, kryetari i autorizuar i trupit gjykues lëshoi një urdhër për të caktuar shqyrtimin kryesor.

Me 15 Shkurt 2010, filloi shqyrtimi kryesor por gjykata duke prannuar që lejimëimi i dhënë të pandehurit për fillimin e shqyrtimit kryesor ishte më i shkurtrë se sa afati 8 ditor që parashihet me ligj, dhe duke prannuar që i pandehuri nuk ishte i pranishëm, vendosi që të shtyjë gjykimin në mënyrë që të mundësohet kohë e mjaftueshme për mbrojtje.

Me 22 Shkurt 2010 i pandehuri prapë ka dështuar të paraqitet dhe trupi gjykses ka lëshuar një urdhër për të pandehurin që të detyrohet të paraqitet para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Pas dështimit të autoriteteve kompetente që ta shoqërojnë atë para gjykatës së qarkut në Prishtinë, gjykimi kryesor është dashur të shtyhet disa herë dhe atë me: 23 Shkurt 2010, 2 Mars 2010, 13 Prill 2010, 15 Prill 2010, 19 Prill 2010, 18 Prill 2010 dhe me 4 Maj 2010.

Të Shtunën me 12 Qershor 2010, i pandehuri eventualisht është arrestuar nga Policia e Kosovës. Të Hënën me 14 Qershor është mbajtur shqyrtimi kryesor.

## **2. Historia e Paraburgimit**

Me 10 Shkurt 2007 i pandehuri Albin Kurti ishte arrestuar dhe paraburgimi ishte urdhëruar;

Me 10 Maj 2007 paraburgimi ishte zëvendësuar me arrest shtëpiak;

Me 11 Maj 2007, për shkak të shkeljes së vendimit të gjykatës, prapë është urdhëruar paraburgimi kundër të pandehurit;

Me 6 Qershor 2007 Arresti shtëpiak prapë urdhërohet për të zëvendësuar paraburgimin;

Me 13 Qershor 2007 urdhërohet paraburgimi prapë për të zëvendësuar arrestin shtëpiak;

Me 11 Korrik 2007 arresti shtëpiak zëvendëson paraburgimin;

Me 19 Dhjetor 2007 i akuzuari llirohet;

Me 30 Janar, urdhërohet paraburgimi kundër të pandehurit;

Me 7 Shkurt 2008 i akuzuari llirohet prapë dhe gjykimi kryesor pezullohet;

Me 12 Qershor 2010 i pandehuri arrestohet nga policia dhe detyrohet të paraqitet para gjykatës së qarkut në Prishtinë me 14 Qershor 2010 dhe në të njëjtën ditë ai llirohet.

### 3. Ligji i aplikueshëm, juridiksioni i Gjykatës dhe përbërja e Trupit Gjykses

Sipas nenit 23 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (më tutje KPPK), Gjykata e Qarkut ka juridiksion për të gjykuar në shkallën e parë për veprat penale të dënueshme me burgim me më së paku pesë vite apo burgim të gjatë, prandaj akuzat kriminale të deklaruara kundër të akuzuarit bien nën juridiksionin e Gjykatës së Qarkut. Gjykata e Qarkut ka juridiksion gjithashtu për pikën 3 të aktakuzës (*medio tempore* të tërhequr nga Prokurori), sipas nenit 33 paragrafi 6 të KPPK.

Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka juridiksion territorial pasi incidentet e përshkruara në aktakuzë kanë ndodhur në Prishtinë.

Procesi penal bie nën juridiksionin e EULEX-it sipas nenit 16.2 të Ligjit mbi Juridiksionin, Zgjedhjen e Rasteve dhe Shpërndarjen e Rasteve gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it (3 – L053/2008), sipas të cilës [omissis] Presidenti i *Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it do të vendosë në përputhje me këtë ligj se cilat raste të dorëzuara sipas Seksionit 16(1) bien brenda juridiksionit dhe kompetencave të gjykatësve apo prokurorëve të EULEX-it, respektivisht, dhe cilat raste tjera për arsye të bazuar do të qëndrojnë nën autoritetin e gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it pas qëndrimit nën autoritetin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të UNMIK-ut [omissis].*

Një Gjykatës Kosovare ka qenë pjesë e Trupit Gjykses gjatë tërë gjykimit sipas nenit 4.7 të Ligjit mbi juridiksionin.

### 4. Shqyrtimi Kryesor

Me 14 Qershor 2010 në ora 10.20 Gjykata e Qarkut në Prishtinë në prani të të Pandehurit, të Prokurorit Publik dhe të Ismet Hajdinit Palë e Dëmtuar, ka dekluar të hapur shqyrtimin kryesor. Nuk ka pasur palë tjetër të dëmtuar të pranishme.

I pandehuri është pyetur nëse dëshiron që të ndihmohet nga një avokat mbrojtës dhe ai ka refuzuar.

Para fillimit të shqyrtimit kryesor , i pandehuri ka dorëzuar një parashtrësë të nënshkruar të përkthyer nga trupi gjykses si një parashtrësë për diskualifikimin e trupit gjykses e cila menjëherë i është dërguar Presidentit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës – kompetente për të vendosur mbi diskualifikimin e Gjykatësës Kosovare Kadu – dhe Presidentit të Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it – kompetente për diskualifikimin e dy gjykatësve të EULEX-it të caktuar në këtë rast.

Shqyrtimi kryesor ka vazhduar në ditën e njëjtë në ora 12:40 dhe, pasi Kryetari i Trupit Gjykses shpalli që parashtrësja për diskualifikim ishte refuzuar nga dy organet kompetente, prokurori publik njoftoi se ai do të tërheq pikat 1) dhe 3) të aktakuzës të datës 31 Maj 2007. Pas leximit të aktakuzës ai konfirmoi këtë tërheqje. Nuk ka pasur kundërshtime të ngritura nga pala e dëmtuar.

Shqyrtimi kryesor më pastaj vazhdoi me vëmendje të veçantë të pika 2) e aktakuzës. Kjo aktuzë (neni 318 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK) dënohet me maksimumin e dënimit me pesë vite burgim, kështu që ra jashtë kufijve të aplikimit të nenit 73 të KPPK (i cili parashleh caktimin e detyrueshëm të një *ex officio* avokati mbrojtës vetëm për krimet e dënueshme me më së paku tetë vite burgim).

Më pas, duke marrë parasysh refuzimin e gartë të Z. Kurrit që të asistohet nga një avokat mbrojtës, Trupi Gjykses ka vazhduar me të pandehurin duke e përfaqësuar veten e tij para gjykatës.

Të akuzuarit i janë drejtuar parajamërimet ligjore dhe ka qëndruar i heshtur gjatë deklarimit (që nënkupton një deklaram jo fajtor sipas nenit 358 të KPPK), dhe është hapur procesi i provave.

Në bazë të propozimit të prokurorisë, janë ekzaminuar tre dëshmitarë. Fragmente nga një video CD që korrespondonte me kohën para dhe pas incidenteve të 10 Shkurtit, që konsistonte me disa sekuenca të përplasjes në të vërtetë, i janë treguar dëshmitarëve.

I pandehuri i morri në pyetje.

Prokurori Publik furnizoi Trupin Gjykses me një kopje shtesë të një CD që ishte në dosjen e lëndës.

Përmbajtja e saj u përmbledh nga Prokurori Publik gjatë shqyrtimit kryesor sipas nenit 367 të KPPK.

Provat materiale të listuara në aktakuzë janë pranuar në fund të procesit të administrimit të provave.

Eventualisht i pandehuri refuzoi që të merret në pyetje.

Të dy palët e mbajtën fjalën përfundimtare dhe në ora 20:10 trupi gjykses pas plogëritimit publikisht shpalli aktvendimin në prani të të gjitha palëve.

## 5. Gjetjet ligjore

### **5.1. Pikat 1) dhe 3)**

Paraprakisht trupi gjykues konstaton që Prokurori Publik në pajtim me nenin 52 të KPPK, është tërhequr nga ndjekja sa i përket pikave 1 (“Pjesëmarrja në Grup që kryen veprë penale” sipas nenit 320 paragrafi 2 të KPPK) dhe 3 (“Thirrje për Rezistencë” siç është përcaktuar dhe që dënohet nën nenin 319 paragrafi 1 të KPPK) të aktakuzës.

Prandaj, sipas nenit 389 paragrafi 1 të KPPK, akuzat penale të Pjesëmarrjes në Grup që kryen veprë penale siç përshkruhet në pikën 1) dhe akuza e Thirrje për Rezistencë, siç përshkruhet në pikën tre duhet të refuzohen.

### **5.2. Pika 2)**

I pandehuri ishte akuzuar, sipas pikës 2) të aktakuzës, për pjesëmarrje në një grup që ka penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Në veçanti, Prokuroria pretendon që si drejtues i grupit prej disa mijëra personave të mbledhur afër Teatrit Kombëtar të Kosovës gjatë marshit protestues, ai ka penguar officerët e Policisë së Kosovës dhe të UNMIK-ut për të kryer detyrën e tyre zyrtare të mbrojtjes së pronës së Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës dhe UNMIK-ut, ku personalisht dhe me të tjerët ka shtyrë përmes një kordoni policor të organizuar, që dënohet nga neni 318 të KPPK. Ky nen thotë siç vijon:

*(1) Kushdo që merr pjesë në grupin e njerëzve që me veprim të përbashkët pengon apo tenton të pengoj personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose në mënyrë të ngjashme e detyron të ekzekutojë detyra zyrtare dënohet për pjesëmarrje me gjohë ose me burgim deri në tri vjet.*

*(2) Udhëheqësi i grupit që kryen veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.*

Prandaj, elemente përbërëse të veprës janë siç vijojnë:

1. I pandehuri kishte genë pjesëmarrës (apo udhëheqës, në rast të paragrafit 2) në një grup të personave;
2. Grupi ka vepruar sipas veprimi të përbashkët;
3. Personi(at) zyrtar ishin duke kryer detyra zyrtare;
4. Ata janë penguar për të bërë këtë si rezultat i atij veprimi të përbashkët.

Të gjitha elementet e tilla, së bashku me *mens rea* duhet të provohet nga Prokuroria në mënyrë që i pandehuri të shpallet fajtor.

Një vërejtje e përgjithshme paraprahe: Shërbimi Policor i Kosovës dhe Policia e UNMIK-ut ishin duke monitoruar afër demonstratën prej fillimit, duke marrë parasysh faktin që një demonstratë e ngjashme e organizuar nga Vetëvendosje disa muaj më herët kishte përfunduar me trazira dhe me dëme materiale të objekteve publike, që ishin shënuar nga hedhja e ngjyrës së kuqe.

Për këtë arsye dosja e lëndës është posaçërisht e pasur me prova dokumentare (fotografi dhe video) të cilat sigurojnë një fotografi të qartë të ngjarjeve.

### **5.2.1. I pandehuri ka udhëhequr një grup të personave, të cilët kanë vepruar sipas veprimit të përbashkët;**

Ka prova të bollshme që me 10 Shkurt një marshim i madh i protestës ishin thubuar në qendër të Prishtinës nën kujdesin e lëvizjes Vetëvendosje në mënyrë që të demonstronin kundër negociatave të “planit të Ahisarit” të cilat ishin duke u mbajtur në atë kohë në nivelin e KB.

Dëshmitë e tilla përbëjnë:

- dy CD<sup>1</sup> të cilat janë shfaqë dhe përshkruar në shqyrtimin kryesor dhe fotografi të shumta që janë në dosjen e lëndës, të bëra nga oficerët e policisë që ishin duke e përcjellë marshimin. CD tjera në dosjen e lëndës sigurojnë përshkrime vizuale shitesë të ngjarjeve të 10 Shkurtit. Demonstrata që nga fillimi në Pejton deri epilogu kaotik para Teatrit Kombëtar është përshkruar gjerësisht. Dosja e lëndës përmban po ashtu raporte të policisë të zyrtarëve që ishin duke operuar dhe të cilët bënë fotografi të dhe videot.
- Deklaratat e tre dëshmitarëve të ekzaminuar gjatë shqyrtimit kryesor<sup>2</sup>, të cilët ishin personalisht të përfshirë në monitorimin dhe mirëmbajtjen e rendit publik gjatë marshimit të protestës. Ata, përveç sigurimit të informatave shitesë siç janë theksuar më poshtë, konfirmojnë që përmbajtja e CD-ve që iu është treguar atyre, të cilat janë në dosjen e lëndës, korrespondojnë me ngjarjet e 10 Shkurtit 2007.
- Deklarata e të pandehurit vet gjatë seancës së paraburgimit.
- Dokumentacioni i përfshirë në dosjen 6 të dosjes së lëndës, sa i përket demonstratave të Nëntorit 2006 dhe Shkurtit 2007.

Të më lartat sigurojnë përshkrimin që pason të ngjarjeve të 19 Shkurtit 2007:

---

<sup>1</sup> Shiko dosjen 7, DVD 6 duke filluar nga minuta 7:00 ss; DVD 8, minuta 9:50 ss.

<sup>2</sup> Besart Ahmeti, Kristë Gjokaj, Ismet Hajdini.

- lëvizja Vetëvendosje ishte organizator i marshimit të protestës, në vijë me qëndrimin politik kundër iniciativës së UNMIK-ut, të Qeverisë dhe të aktoreve tjerë ndërkombëtar.
- Marshimi ka filluar nga godina e Vetëvendosjes në Pejton në drejtim dhe përgjatë Rrugës Nëna Teresë.
- Demonstrata ishte supozuar të përkohjoi itinerarin e njëjtë të marshimit të mëparshëm që kishte ndodhë në Nëntor 2006, e organizuar prapë nga Vetëvendosje;
- Është e pamundur të jepet një llogari e saktë të numrit të pjesëmarrësve në marshim. Aktakuza flet për mijëra persona. Çka është e sigurt nga videot dhe fotografi të bashkëngjitura në dosjen e lëndës është që kur marshimi ka arritur te Teatri Kombëtar ishte i përbërë nga më së paku disa qindra njerëz;
- Albin Kurti ishte në mes udhëheqësve të Vetëvendosjes, figura kryesore e marshimit të 10 Shkurtit 2010. Ai (shiko, mes tjerash CD video nr. 8 të dosjes 7) ishte me marshimin deri sa arritën te kordoni policor që ishte vendosur para Teatrit Kombëtar<sup>3</sup>. Ai e mbajti fjalimin përfundimtar nga podiumi që ishte përgatitur mbi një kamion që ishte me turrën.
- Kamioni/podiumi ishte i mbuluar me shenja<sup>4</sup> të Vetëvendosjes. Një numër i madh i aktivistëve të Vetëvendosjes, të gjithë të veshur me bluza të bardha sikur i pandehuri vet, ishin duke drejtuar turrën.
- Fjalimi i tij zgjati disa minuta, fjalët që përfshihen në pjesën e fundit të cilat Prokurori Publik i risjellë në aktakuzë: “*Ne do të vazhdojmë me marshimin tonë protestues, deri sa unë do të vi postë ne do të vazhdojmë sipas skenarit tonë në drejtim të institucioneve dhe këre radhë ne do të marrim kthesën sikur me 28 Nëntor, në anën tjetër. Pra të “parkojmë veten tonë”<sup>5</sup> deri te vetëvendosja të parkojmë veten tonë*”<sup>6</sup>.
- pas përfundimit të fjalimit, dhe në ekzekutimin e urdhrit të dhënë në fjalim, aktivistët e Vetëvendosjes që ishin para turrës filluan njëherësh dhe shpejtë të largojnë pengesat e metalta që formonin kordonin e policisë, kështu që eliminuan vijën e parë të pengesave që bllokoi marshimin;

<sup>3</sup> Pengesa policore ishte e përbërë nga vija e parë e murit metalik, pas së cilës ishte kordoni njëzetor i përbërë nga zyrtarët e Policisë së Kosovës. Pas kordonit të oficerëve të policisë një numër i forcave tjera policore ishin të shpërndara, të gatshme të ndërhyjnë në rast që thyhet kordoni policor nga demonstruesit.

<sup>4</sup> Shiko fotografiminë në dosjen 7.

<sup>5</sup> Kjo shprehje ka mbetur e paqartë.

<sup>6</sup> DVD 8 në min. 30, ff, përmban pjesë të rëndësishme të fjalimit.

- aktivistët e njëjtë, që formonin kordonin përballë kordonit të policisë, përguan turmën nga ecja shumë herët në drejtim të kordonit të policisë, si p.sh. para se Albin Kurti të arrinte në front të marshimit<sup>7</sup>, kur ai arriti në krye të marshimit ai u vendos mu në mes të vijës së aktivistëve që ishte përballë kordonit të policisë;
- pas kësaj, njëherësh turma lëvizi kundër kordonit të policisë, duke ndjekur Albin Kurtin (i cili ishte i pari të lëvizë) dhe eventualisht kanë thyer kordonin e policisë në mes (trëhëna është posaçërisht e dukshme në imazhet që përmban DVD e siguruar dhe përmbledhur nga Prokurori Publik gjatë shqyrtimit kryesor)<sup>8</sup>.

Roli i Albin Kurtit udhëheqësit të përgjithshëm brenda lëvizjes Vetëvendosje mund të shihet si njohuri e zakonshme.

Roli udhëheqës i Albin Kurtit në demonstratën e 10 Shkurtit 2010 duket qartë nga përshkrimi në lartë, posaçërisht me ekzaminimin e provave të lidhura me epilogun e marshimit, para Teatrit Kombëtar.

Me të vërtetë:

- marshimi ishte organizuar në detaje dhe Albin Kurti ishte figura kryesore gjatë fjalimeve të mbajtura turmës;
- pjesa e fundit e fjalimit të të pandehurit ishte porosia e qartë turmës për të vazhduar me marshim sipas planit (pra përgjatë Rrugës Nëna Terezë) pavarësisht pranisë së pengesave të policisë. Ishte, me fjalë tjera një ftesë për të thyer kordonin e policisë.
- Sjellja pasuese e Albin Kurtit ishte aktualizimi i porosisë së mëparshme. I pandehuri kaloi nga fjalët në vepra duke udhëhequr turmën, duke e drejtuar kundër kordonit të policisë.
- Turma, në fakt, eventualisht lëvizi përpara në një mënyrë të koordinuar kur udhëheqësi (Albin Kurti) filloi të ecë dhe shtyu kundër kordonit të policisë, të mbështetur nga pjesa tjetër e turmës, e cila ju dha fuqi.
- Kështu që kishte një relacion arsye-efekt të qartë në mes urdhrave-veprimëve të Albin Kurtit dhe sjelljes së turmës kundër Policisë.

<sup>7</sup> Shiko Dosjen 7, DVD 6 fillimi deri minuta 15:40; DVD 8, minuta 31 ss. Shiko po ashtu CD e cila është siguruar dhe shpjeguar nga Prokurori Publik gjatë seancës së 14 Qershorit 2010.

<sup>8</sup> Shiko Dosjen 7, DVD 8, minuta 34 ff, DVD 5 minuta 52 ff. Po ashtu shiko deklaratat e dhëna nga dëshmitarët Ahmeti dhe Gjokaj gjatë shqyrtimit kryesor. Besart Ahmeti në mënyrë të kaptimeplotë thotë që "Kur u larguan pengesat ishte formuar një kënd për të depërtuar më tej".

## 5.2.2. Veprimet e përbashkëta të grupit penguan personat zyrtar në ushtrimin e detyrave zyrtare

### 5.2.2.1. Personat zyrtar ishin thirrur për të kryer një detyrë zyrtare

Kualifikimi i personit zyrtar është i përcaktuar në KPPK në nenin 107 paragrafi 1) n. 3, që definoi (në mes tjerash) atë si “*një person i cili ushtron detyra zyrtare specifike, bazuar mbi autorizimin e siguruar me ligj*”.

Termi “detyrë zyrtare” i referohet aktiviteteve që ushtrohen nga personat zyrtar brenda kufijve të funksioneve të tyre apo fuqisë së deleguar.

Në rast specifik, SHPK dhe Policia e UNMIK-ut po ashtu qartë janë të konsideruar si persona zyrtar sipas një definicioni të tillë.

Atyre iu është dhënë një detyrë specifike nga eprorët e tyre (pra detyrë zyrtare) për të formuar një pengesë policore<sup>9</sup> në mënyrë që të parandalojnë turmën që të vazhdoj marshimin përgjatë Rrugës Nëna Terezë, kështu që të arrijnë deri te ndërtesat e qeverisë dhe ndoshta të dëmtojnë ato duke hedhur ngjyrë (sikur që ndodhi në rastin e proteste tjetër të ngjashme të organizuar nga Vetëvendosje me 28 Nëntor 2006: shiko në mes të dokumenteve, gazetave që dokumentojnë dëmet materiale gjatë demonstratave të Vjeshtës së 2006, si dhe konferenca për shtyp e Vetëvendosjes dhe buletinet e përfshira në dosjen 6).

Më saktësisht, detyra e oficerëve të policisë që formonin pengesën ishte të mbajnë demonstruesit *prapa* vijës së formuar nga pengesa vet.

I pandehuri dukej sikur pohonte gjatë shqyrtimit kryesor që veprimet e demonstruesve gjatë tentimit të detyrojnë kordonin e policisë ishte i justifikuar, në atë që policia nuk kishte autorizim – me vendosjen e një kordoni të tillë – për të kufizuar të drejtën e qytetarëve të demonstrojnë.

Mbrojtja e tillë është qartë e pabazuar, jo vetëm në bazë të legjislacionit në Kosovë, por gjithashtu duke marrë parasysh parimet e ruajtura në Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

---

<sup>9</sup> Shiko procesverbalin e gjyqimit, versioni Anglisht, dëshmia e Besart Ahmetit, faqe 5; Kristë Gjokaj, faqe 14.

Një instrument ndërkombëtar i tillë, në fakt, deri sa afirmon (në nenin 11<sup>10</sup> të tij) të drejtën e qytetarëve të mblihdhen, të njëjtën kohë siguron për kundërpeshën e domosdoshme kundër rrezikut të keqpërdorimit të mundshëm e të drejtës së tillë (apo, nëse përdorim fjalët e nenit 11 të konventës, “në mënyrë që të parandalohet trazirra”). Kështu që është e qartë që administratat e Shtetit kanë fuqinë për të imponuar kufizime mbi liritë e grumbullimit dhe demonstrimit kur kjo justifikohet nga nevoja për të parandaluar trazirat, apo për të parandaluar rrezikun e bazuar të shkeljes së të drejtave tjera të në mënyrë të ngjashme të mbrojtura nga Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

Kjo është saktësisht çka ka ndodhur në rastin aktual. Me të vërtetë:

- Policia nuk e ka penguar marshimin e protestës *tout court*: marshimi – megjithatë, me sa duket, i pautorizuar – ka mundur të ndodhë dhe në të vërtetë u zhvillua vet në paqe për pjesën më të madhe të itinerarit;
- Policia thjesht pengoi protestuesit nga avitja shumë afër ndërtesës së Qeverisë (të cilat ishin, dosido, në distanca shikimi), duke marrë parasysh faktin që në marshimin e mëparshëm të organizuar nga Vetëvendosje me 28 Nëntor 2006 demonstruesit kishin dëmtuar ndërtesat publike duke hedhur ngjyrë në to<sup>11</sup>.

Kjo është e mjaftueshme në mënyrë që të konfirmohet që me imponimin e një kordoni të tillë në afërsi të ndërtesave të qeverisë ishte masë e sigurisë e arsyeshme dhe ligjore, duke goditur një barspeshë të drejtë në mes të drejtës së qytetarëve për të demonstruar dhe detyrës së Policisë për të mbrojtur pronën publike dhe të pengoj trazirat<sup>12</sup>.

Do të ishte e çuditshme për të menduar ndryshe, dhe të pranohet nocioni i çuditshëm “liria e demonstrimit” e mbështetur nga i pandehuri, sipas të cilit Policia duhet të lejoi protestat të cilat në bazë të vlerësimit të arsyeshëm, kanë për qëllim të dëmtojnë godinat publike<sup>13</sup>.

<sup>10</sup> 1. *Çdokush e ka të drejtën e lirisë së mblledhjes pagësore dhe të liria e shogërimit me të tjerë...2.*

*Nuk do të vendosen kufizime në ushtrimin e këtyre të drejtave përveç në ato që përshtatohen me ligj dhe që janë të domosdoshme në shogëri demokratike në interes të sigurisë shtetërore apo sigurisë së publikut, për parandalimin e trazirave apo krimiti për mbrojtjen e shëndetit apo moralit apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.*

<sup>11</sup> Shiko dokumentacionin në dosjen 6 të lëndës dhe deklaratat e dhëna nga Albin Kurti në dëgjimin mbi paraburgimin.

<sup>12</sup> Kjo nuk nënkupton që reagimi pasues i Policisë dhe modalitetet në të cilat plumbat e gomës janë përdorë të ishte e duhur dhe proporcionale. Vlerësimet e tilla megjithatë bien jashtë sferës së këtij gjykimi.

<sup>13</sup> Është rasti që të shohet që policia ka konfiskuar nga kamioni që ishte duke përcjellë demonstruesit më shumë se njëqind shishe të ngjyrës së kuqe: shiko raportet e policisë që përmban dosja n. 5 dhe dokumentacioni fotografik i materialet të konfiskuar. Dosja e lëndës po ashtu përmban ekspertizën kimike të bërë në ngjyrë që ishte konfiskuar në kamion dhe në shisheën e ngjyrës që ishte konfiskuar

Askush nuk është mbi ligjin dhe e njëjta vlen për Albin Kurtin, i cili nuk mund ti imponoj popullatës (dhe policisë) pikëpamjet e tij personale mbi demonstratat publike dhe në lidhje me të drejtën e pretenduar për të dëmtuar godinat publike si formë e protestës politike.

Në përfundim, duke marrë parasysh që detyra zyrtare e policisë përbëhet mbi mbajtjen e demonstruesve prapa vijës së shënuar me rrethojë dhe me vijën e parë të oficerëve të Policisë së Kosovës, faktet e përshkruara më lartë tregojnë që elementi material i veprës përshkruar me nenin 318 të KPPK është i përmbyshur<sup>14</sup>.

#### **5.2.2.2. Grupi me dashje penguan personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.**

*Mens rea* e të pandehurit është vërtetuar po ashtu, sa i përket:

- Dijenisë së tij për kualitetin e personave zyrtar të policëve të cilët përbënin kordonin e policisë;
- Fakti që ata ishin duke vepruar në kryerjen e një detyre zyrtare;
- Dëshira e tij për të lëvizur kundër kordonit të policisë;

Në këtë rast specifik, videot dhe fotografitë që përbën dosja e lëndës dhe dëshmitë e dëshmitarëve Besart Ahmeti dhe Kristi Gjokaj e kanë bërë të qartë:

- Që ka qenë qartë e dukshme që kordoni ishte i përbërë nga persona zyrtar;
- Që një kordon i tillë ishte menduar të mbaj demonstruesit prapa vijës së formuar nga ta. Kjo është sa i përket shtirjes fizike të strukturës vetvetiu (që ishte vendosur përgjatë rrugës në gjerësinë e plotë). Duhet të shtohet që i pandehuri dhe protestuesit ishin parajohmëruar nga Policia me megafon që pengesa e Policisë nuk duhet të kalohet pa leje dhe se mosbindja e një urdhri të tillë përbënte veprë penale<sup>15</sup>.

Përmbajtja e fjalimit të pandehurit (duke nxitur turmën që të lëvizin me marshim pavarësisht pranisë së kordonit të policisë) *in re ipsa* konfirmon dijeninë e të pandehurit për natyrën e pengesës që ndalonte atë dhe dëshirën e tij që të çaj tejprtej.

---

brenda godinës së Vetëvendosjes : kjo ekspertizë konfirmoi që të gjitha shishet e ngjyrës kishin përbërjen e njëjtë.

<sup>14</sup> Vija e hollë e policëve të Kosovës ka qenë plotësisht e pushtuar nga turma gjigante e cila ishte duke përcjellë Albin Kurtin, siç është bërë e qartë nga ekzaminimi i CD që janë përmendur më lartë, nga deklaratat e dëshmitarëve në shqyrtimin kryesor dhe nga raportet e policisë të përfshira në dosjen e lëndës (shiko p.sh. raportin e oficerit në dosjen 6, faqe 1845).

<sup>15</sup> Shiko në këtë, për shembull, deklaratat e dëshmitarit Besart Ahmeti në faqe 10, degjimi i datës 14 Qershor 2010.

Veprimet e tij menjëherë pas fjalimit konfirmojnë fjalët që ai ka folur dhe vendosmërinë solide për të ndjekur qëllimin e tij.

#### **6. Përfundimet dhe parimi i dënimit**

Të dyja, elementi material dhe mendor i krimit për të cilën akuzohet Albin Kurti janë provuar.

Trupi Gjykuës nuk kishte mundur të gjej ndonjë dëshmi të rëndësishme shfaqësuese në dosjen e lëndës; të njafueshme për të përgjashuar Albin Kurtin nga përgjegjësia.

Periudha e parashkrimiti nuk ka kaluar.

Albin Kurti duhet, prandaj, të shpallet fajtor për krimin për të cilin akuzohet.

Kur të vendoset për dënimin gjykata duhet të mbaj në konsideratë modalitetet e kryerjes së veprës dhe personaliteti i të pandehurit. Dënimi duhet po ashtu të jetë sigurues i dëhur kundër krimeve tjera dhe një sanksionim proporcional për veprën e cila është kryer.

Paraprakisht duhet të mbahet në mend që Prokurori ka tërhequr pikën 1) të aktakuzës, e cila përmblante akuzën më serioze (pjesëmarrja, në rolin kryesor, në një grup që kryen veprë penale dhe pikën 3).

Trupi gjykuës mendon që dënimi duhet të jetë në pragun e ultë që parashihet me nenin 318 të KPPK, dhe se rrethanat e neni 66 të KPPK duhet të gjejnë aplikim.

Me të vërtetë, sa i përket motiveve për (dhe rrethanat në) të cilat krimi ishte kryer, trupi gjykuës konsideron që veprimet e të pandehurit kanë ndodhur në kuadër të një demonstrate të protestës politike.

Pjesëmarrja në këto lloje të manifestimeve dhe organizimi i tyre, edhe nëse nuk është *per se* e njafueshme si kauzë e justifikimit siç është shpjeguar më lartë, duhet megjithatë të konsiderohet në parim (deri aty ku mesazhi që bartet nuk është në kundërshtim me ligjin, që nuk është rasti këtu) si element pozitiv, më së shumti në kuadër të një shoqërie tranzicioni, sikur Kosova.

Demonstrata ishte planifikuar si paqësore, dhe ishte mbajtur e qetë deri kur ishte përballur me kordonin e policisë.

Veprimi i njëjtë duke shtyrë kordonin në mes, megjithëse teknikisht përbënte presion fizik (sepse konsistonte me shtyrje fizike përmes kordonit të policisë, duke bërë presion kundër policëve në mes të kordonit), ishte bërë nga një fakt i thjeshtë i vazhdimi të ecjes, me videot që tregojnë që demonstruesit nuk ishin duke goditur apo qëlluar oficerët e policisë.

Kjo tregon që qëllimi i demonstruesve nuk ishte të dëmtoj integritetin fizik të policëve.

Kjo nënkupton po ashtu që sasia e presionit fizik kundër personave ishte e mbajtur nga demonstruesit në minimumin e sasisë së mundshme që ju dha mundësi të tejkalojnë pengesën.

Elementet më lartë tregojnë që intensiteti i trezikut apo lëndimit të vlerës së mbrojtur të shkaktuar nga veprimi i të pandehurit (që është në mes të kriterëve të vlerësimit të listuar në nenin 64 të KPK) ishte i ulët.

Kjo gjithashtu reflekton mbi intensitetin e elementit mendor të pandehurit, që mund të konsiderohet si i ulët.

Është e vërtetë që pasi kordoni i policisë ishte thyer kishte një përshkallëzim të dhunës: kjo, megjithëse, bie jashtë sferës së këtij gjykimi dhe nuk duket, sidogofë, të ketë qenë pjesë e planit original të organizatorëve.

Duhet të shtohet që politika e përgjithshme e lëvizjes Vetëvendosje (së paku në deklaratat e liderëve të saj, siç shihen në dokumentet që përbëjnë dosja e lëndës) duket që konfirmon këtë gasje kundër drejtimt të dhunës kundër personave.

Sjellja e të pandehurit para dhe pas kryerjes së krimt nuk përbën elemente të cilat e shtojnë llogaritjen e dënimit.

Fakti që i pandehuri (në vijë me bindjet e tij politike personale) ka konfirmuar që nuk e njuh gjykatën, shqyrtimi i përbërjes së trupit gjykues, nuk mund të konsiderohet *iso facto* si element negativ për llogaritjen e dënimit.

Duke marrë parasysh së bashku rrethanat më lartë, trupi gjykues mendon se është e përshatshme të vë dënimin prej nëntë muaj burgim.

Koha e kaluar në paraburgim deri më tani nga i akuzuari do të llogaritet si pjesë e dënimit me burgim sipas Nenit 391 paragrafi (1) nënparagrafi 5 të KPPK. Kjo konsiston që dënimi kundër të akuzuarit është kryer deri më tani.

## **7. Shpenzime**

I akuzuari duhet të kompensoj shpenzimet e procesit penal sipas Nenit 102 Paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të shpenzimeve të interpretimit dhe përkthimit. Një vendim i veçantë mbi shumën e kostos do të bëhet nga gjykata kur këto të dhëna merren sipas Nenit 100 Paragrafi (2) të KPPK.

Për atë se çka u tha, është vendosur sikur në dispozitiv.

E përgatitur në Anglisht, gjuhë zyrtare.

**Prishtinë, 14 Qershor 2010**

<b>Kryetar i Trupit Gjykses</b>	<b>Officeri regjistrues</b>
Ferdinando Buatier de Mongeot,	Francesco Carruso
Gjykatës i EULEX-it	Officer ligjor i EULEX-it

**Anëtarë të Trupit Gjykses**

Vladimir Kanev	Felleza Kadu
Gjykatës EULEX-it	Gjykatës i Kosovës

## **Këshilla juridike**

Sipas Nenit 400 par. 1) të KPPK-së, ankesa kundër këtij aktgjykimi duhet të shpallet menjëherë dhe jo më vonë se 8 ditë nga data e publikimit të shpalljes. Sipas nenit 398 të KPPK, par. 1) personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesën kundër aktgjykimit të shpallur në shkallën e parë brenda pesëmbëdhjetë dite nga data e dhënës së kopjes së aktgjykimit.